


Zona stratigrafike e Mirditës

Është një nga zonat më të rëndësishme të Albanideve dhe shtrihet nga Tropoja në Bilisht-Leskovik. Në këtë zonë përfshihen ofiolitet dhe dy brezat karbonatik të moshës triasik-jurasik. Vendoset në perëndim të zonës së Korabit. Në ndërtimin gjeologjik, mbizotërojnë shkëmbinjtë ofiolitik, shkëmbinjtë e periferisë karbonatike të ofioliteve, depozitimet e kufirit jurasik-kretak, depozitimet karbonatiko-terrigjen si dhe depozitimet flishoidale eocenike e mollaset eocenike-oligocenike-neogjenike dhe depozitimet pliokuaternale dhe kuaternale. Shkëmbinjtë ofiolitik kanë përhapje hapësinore mjaft të madhe. Ato ndërtojnë preje me trashësi vertikale 3-4 km. Karakteristikat e tyre janë ndryshimet e theksuara faciale në shtrirje dhe tërthorë përhapjes së ofioliteve. Mbulesa më e hershme sedimentare e ofioliteve janë depozitimet argjilite copëzore që përbëjnë pjesën e poshtme të prerjes së depozitimeve të kufirit jurasik-kretak e që vendosen në pajtim strukturor mbi vullkanitet e kreut të prerjes ofiolitike. Nga pikëpamja strukturore depozitimet e kretakut kanë vendosje mospajtuese në sektorë të ndryshëm të bazamentit ofiolitik. Në gjysmën veriore të zonës Mirdita kemi një zonalitet tërthor deri koncentrik që konsiston në shkëmbinjtë ultrabazik pa ose me mbulesa vullkanogjene dhe në pjesët qendrore të shkëmbinjve gabroplagjiogranitikë me mbulesë të trashë të shkëmbinjve vullkanogjenë bazalto-keratofirik. Brenda këtij kuadrati ofiolitik evidentohen një sërë strukturash të rrudhosura. Stratigrafinë e zonës Mirdita do ta analizojmë në dy pjesë të rëndësishme: Stratigrafia e periferisë karbonatike të ofioliteve, Stratigrafia e mbulesës sedimentare të ofioliteve.



Litologjia dhe Fauna e periferisë karbonatike të ofioliteve lindore dhe perëndimore

Triasik i mesëm (anizian). Dolomite masive sipër tyre gëlqeror nodularë. Ranorë arkozikë, gëlqeror e mergele. Efuziv bazik. (*Amonitë embrionalë, bivalvë pelagjike; ostracoda, glomospirella cf.*)

Triasik i mesëm (anizian). Ndërthurje gëlqerorësh, shtresorë dhe masivë. Shpesh ata janë algorë. Gëlqeror radiolaritikë. Midis gëlqerorëve ndodhen thjerza silicorësh. Ndërthurje gëlqerorësh me silicorë. Gëlqerorë radiolaritikë. (*Bivalva pelagjike, Ostracoda, Textularide, korale, radiolarie, krinoidë*).

Triasik i sipërm. Gëlqeror neritikë në përgjithësi të facies algore ku predominojnë alget, koralet, megalodontët.

Gëlqeror radiolaritikë pelagjikë, me ndërshtresa silicorësh me bivalva pelagjike. (*Triasina hantkeni, Involutina sp. Trocholina sp. Endothyra sp. Trochomina etj.*)

Jurasik. Reshpe silicore radiolaritike. Gëlqeror nyjor të kuq. (*Bivalvorë pelagjikë, amonite, Involutina liassica, lenticulina*).

Titonian-kretak i poshtëm. Depozitime konglobrekçore ofiolitike dhe mergelore ranorike me kalpionelidë.

Litologjia dhe Fauna e mbulesës sedimentare të ofioliteve.

Jurasik i sipërm. Silicorë radiolaritk, pllakë hollë dhe rralle masiv. (*Radiolarite, Holo cryptokapsa sp. Eucyrdiuno sp, Tricolopsa*).

Titonian-kretak i poshtëm. Depozitimet argjilito-copëzore. Argjila, rreshpe argjilore, ranorë, silicorë, konglomerate, blloqe shkëmbinjsh ofiolitik dhe blloqe shkëmbinjsh gëlqerorë, silicorë.

Depozitimet e konglobrekçieve ofiolitike: shkëmbinj ultrabazik, vullkanite, rrallë copa amfibolitesh, rreshpe, kuarc mikor, granitike. Ndërmjet tyre ndodhen rrallë shtresa konglomeratesh (*Crasicollaria intermedia, Calpionella alpina, Lorenziella sp, Calpionella elliptica, Calpionella obonga, Tintinopsella amonite, Beriasella oppeli, B. privasensis* etj).

Kretak i poshtëm. Facia terrigjene dhe terrigjeno-karbonatike: konglomerate, ranorë dhe ndërthurje konglomerato-ranorë.

Depozitimet konglomeratike: Gëlqeror deri në gëlqeror konglomeratik me gastropodë, rudistë, alga. (*Nautiloculina oolithica, Nerinea Pauli, Disoptyxis traversensis, D. Coquandi* etj).

Kretak i sipërm. Gëlqeror neritik, biomikritik, biopelmikritik, gëlqeror konglobrekçiorë shtresë mesëm deri shtresë trashë me foraminifere bentosik, alga, rudistë etj. (*Dicyclina sp, schumberger, Biconcava bentori, rudisti hipurites, rotalide, Nezazzata simplex* etj).